



**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
*Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 06.06.2019

Dokument parlamentar

**RAPORT**  
**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR”**  
**(NISMË E NJË GRUPI DEPUTETËSH)**

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar”, në mbledhjet e datës 28 maj dhe 6 qershor 2019.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Besnik Baraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin propozuesit e nismës, të përfaqësuar nga deputetja Elena Xhina.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar” është një nismë e propozuar nga një grup deputetësh, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit, mbështetur në nenin 81 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të cilësuar votash, prej tri të pestat, sipas nenit 81 të Kushtetutës.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji i propozuar është hartuar nga një grup deputetësh të Partisë Socialiste dhe përfaqëson një materializim të vullnetit të mazhorancës qeverisëse për realizimin efektiv të të drejtave dhe lirive të shtetasve në disa fusha.

Ndryshimet e propozuara në Kodin Penal janë hartuar në përgjigje të problematikave të shfaqura kohët e fundit dhe përfshijnë ndryshime në disa fusha, si: rendi dhe qetësia publike/ndalimi i zhurmave; mjedisi, shëndetësia, siguria ushqimore etj.,.

Këto ndryshime përfshijnë riformulime, dekriminalizim veprash, apo shtim të disa figura të veprave të reja, që lidhen me: mbrojtjen nga dhuna e profesionistit shëndetësor; mbrojtjen nga dhuna e policit, funksionarit publik, të zgjedhurit dhe personelit të shërbimit publik; mbrojtja e së drejtës së autorit; ndalimi i veprimtarisë së lojërave të fatit; dekriminalizimi i gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut; përdorimi i armëve dhe lëndëve plasëse pa leje të organeve shtetërore; mbrojtja nga kafshët shoqëruese në publik; mbrojtjen nga dhuna në sport.

- ***Konsultimi publik***

Gjatë shqyrtimit në Komision, propozuesit njohën deputetët me faktin se, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar një procesi të gjerë të konsultimi me institucionet që preken, me shoqata dhe organizata biznesi, me Euralius, etj.

Në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes, mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare, si dhe bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni zhvilloi një séancë dëgjimore me përfaqësues të Bashkimit Tregtar të Shqipërisë (BTSH), të Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë (BPSH) dhe të Qendrës së Eksporteve Shqiptare (AFI).

Përfaqësuesit e tyre paraqitën në Komision vlerësime, vërejtje dhe sugjerime për projektligjin, në fushën e sigurisë ushqimore, si dhe propozuan riformulime për përmirësimin e tij.

Përfaqësuesi i BTSH dhe i BPSH, z. Luan Leka prezantoi problematikën që, sipas tij, përmban projektligji i propozuar, të cilat lidhen me faktin se projektligji nuk referohet në ligjet për ushqimin dhe për etiketimin; nuk përcakton përgjegjësinë e qartë të personave në rastin e veprave që parashikon; nuk evidentohet ana subjektive e veprës, duke mos bërë dallimin ndërmjet një veprimi të kryer me dashje dhe një tjetre të kryer nga pakujdesia; dënimet e parashikuara nuk janë proporcionale me dëmin e shkaktuar.

Gjithashtu z. Leka paraqiti edhe propozime për riformulime të nenit 288 të Kodit Penal, me qëllim krijimin e një ndarje të qartë të përgjegjësive ndërmjet prodhuesit dhe tregtarit, importuesit/distributorit, apo tregtuesit të drejtpërdrejtë, si dyqani/marketi, tek konsumatori final, për të identifikuar përgjegjësin e drejtpërdrejtë që ka kryer veprën penale, si dhe riformulime të nenit 288/c dhe 288/d, duke synuar

ndarjen në paragrafë të veçantë, veçmas për prodhuesin dhe veç për pjesën tjetër të zinxhirit; heqjen e termit “ruajtja” e produkteve, pasi ruajtja është një proces i gjatë në pritje të asgjësimit dhe parashikimin e dënimit fillimisht me gjobë dhe më pas, në rast përsëritje, parashikim i dënimit me burgim.

Përfaqësuesi i AFI-së, Z. Alban Zusi paraqiti në Komision problematikat, sipas tij, të pazgjidhura ndër vite, që paraqet zinxhiri i sigurisë ushqimore, të cilat lidhen me identifikimin/matrikullimin e kafshëve; regjistrimin e kafshëve; gjurmueshmërinë e produkteve shtazore; standardizimin (aktualisht nuk ekzistojnë standarde shtetërore të prodhimit për pjesën më të madhe të produkteve të përpunuara ushqimore); certifikimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë, i cili ekziston vetëm tek një numër i limituar i operatorëve të biznesit ushqimor; dhe inspektimin/monitorimin.

Gjithashtu, z. Zusi argumentoi nevojën për plotësimin fillimisht, të legjislacionit të nevojshëm në fushën e sigurisë ushqimore, si parakusht për zbatimin e ndryshimeve të propozuara në Kodin Penal dhe nevojën e zhvillimit të një procesi të gjerë konsultimi publik me palët e interesuara, përpunues apo fermerë prodhues të lëndëve të para, përpara miratimit të ndryshimeve të propozuara në Kodin Penal.

- ***Diskutimi në Komision***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar”, u shqyrtua nga Komisioni Për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datës 28 maj dhe 6 qershor 2019.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit ishin edhe përfaqësues të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ministrisë së Drejtësisë, ministrisë së Bujqësisë dhe zhvillimit Rural dhe përfaqësues të Prokurorisë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision deputetët vlerësuan nismën dhe i kërkuan shpjegime propozuesve lidhur me nevojën që ka çuar në kryerjen e këtyre ndryshimeve.

Propozuesit e projektligjit u shprehën se domosdoshmëria për amendimet në Kodin Penal për disa çështje, si prishja e qetësisë dhe rendit(goditja e policit), dhuna në shëndetësi, dhuna në aktivitete sportive, dhuna ndaj funksionarëve publikë apo të zgjedhurve, ka lindur referuar ngjarjeve të muajve të fundit ku incidentet e dhunës kundër mjekeve, ato në ndeshjet sportive, goditja ndaj policit apo veprat e dhunës kundër deputetëve e të zgjedhurve të tjerë kanë qenë të shpeshta, ndërkohë që parashikimet aktuale në Kodin Penal, rezulton se nuk garantojnë parandalimin për veprimet e dhunës.

Nevoja për ndryshime në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit vjen si pasojë e debatit të gjerë publik për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë kundër kopjimeve apo përdorimeve të padrejta të veprave të tjerëve. Kodi Penal ka disa parashikime për mbrojtjen e pronësisë intelektuale apo riprodhimin e padrejtë të veprës së tjetrit, por dispozitat nuk janë të plota sa i takon mbrojtjes së të drejtës së autorit, dhe dënimet përkatëse nuk i përgjigjen realitetit.

Nevoja për ndryshimet që propozohen për ashpërsimin e dënimeve në veprimtarinë e lojërave të fatit vjen si pasojë e miratimit të legjislacionit të ri në vend për ndalimin e veprimtarisë së lojërave të fatit dhe bixhozit.

Nevoja për ndryshimet në lidhje me rendin dhe qetësinë publike vjen si pasojë e ankesave në rritje të qytetarëve, pasi subjektet tregtare nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit për zhurmat.

Ndryshimet që propozohen për dekriminalizimin e gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut, bëhen me qëllim përmirësimin e klimës në të cilën profesionistët e shëndetit kryejnë detyrën e tyre dhe përmbushin misionin e tyre. Dispozita ekzistuese në Kodin Penal ka sjellë vështirësi për profesionistët e shëndetit në kryerjen e detyrave të tyre dhe vështirësi në zbatimin e praktikës gjyqësore.

Ashpërsimi i dënimeve për mbajtjen e armëve, armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse në kundërshtim me parashikimet ligjore apo pa leje të organeve kompetente dhe për veprimet që synojnë pengesat apo ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror, synon frenimin e përdorimit të armëve apo lëndëve plasëse, si dhe parandalimin e veprimeve që pengojnë qarkullimin e transportit në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Ndryshimet që propozohen në fushën e mbrojtjes së mjedisit kanë për qëllim të transpozojnë plotësisht Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal, e cila nuk është transpozuar ende.

Propozimi i veprave penale të kryera nga persona fizikë a juridikë, me dashje apo nga pakujdesia, të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese apo me lejet/autorizimet që janë miratuar në zbatim të tyre dhe që rrezikojnë të shkaktojnë ose shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo, jetën e njeriut, synon transpozimin në ligjin penal të legjislacionit tematik/administrativ të Acquis së BE për mjedisin, të miratuar në përputhje me Traktatin e KE-së dhe aktet për rrezatimet jonizuese të miratuara në përputhje me Traktatin e Euratomit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit tek të gjithë aktoreve që veprojnë dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë përmes aktiviteteve të tyre.

Ndryshimet që propozohen në fushën e sigurisë ushqimore, synojnë rishikimin e dispozitave ekzistuese që lidhen me sigurinë ushqimore, krijimin e figurave të reja të veprave penale, duke kriminalizuar fenomene/sjellje të cilat aktualisht janë kategorizuar si forma të kundër-vajtjeve administrative, apo nuk kanë asnjë parashikim të mirëfilltë ligjor si shkelje, pasi çështja e sigurisë ushqimore është një nga çështjet më aktuale dhe më të ndjeshme në ditët e sotme.

Relatori prezantoi ndryshimet e propozuara në Kodin Penal për fushat të cilat janë në fushën e përgjegjësive së Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, që janë ato që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen nga kafshët shoqëruese në publik.

Gjithashtu relatori ngriti shqetësimet e tij lidhur me dekriminalizimin e ndotjes së ujërave, duke qenë se neni 203 i KP është riformuluar duke parashikuar një vepër tjetër, atë të të prodhimit, importimit,

eksportimit nxjerrjes në treg ose përdorimi i substancave ozon-holluese, në shkelje të kërkesave të legjislacionit.

Ai propozoi që vepra penale e ndotjes së ujërave të qëndrojnë në Kod, duke i sugjeruar Komisionit Përgjegjës përfshirjen e saj në një tjetër dispozitë.

Gjithashtu, relatori evidentoi se në aspektin formal, projektligjit i mungon baza ligjore. Për këtë arsye kërkoi që t'i sugjerohet Komisionit Përgjegjës të plotësojë projektligjin në aspektin formal, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores.

Përfaqësuesit e ministrive vlerësuan nismën e propozuar, shprehën qëndrimin e tyre lidhur me përmbajtjen e projektligjit, si dhe sugjeruan riformulime të dispozitave përkatëse, sipas fushave të tyre të veprimtarisë.

Diskutimet e deputetëve në Komision u fokusuan kryesisht në fushat të cilat janë në përgjegjësi të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i mbetjeve, siguria ushqimore dhe trajtimi i kafshëve, por edhe në dispozitat lidhur me trajtimin e gabimit mjekësor dhe me organizimin e lojërave të palejuara.

- ***Përfundim***

**Në përfundim të diskutimeve**, Komisioni me unanimitet miratoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin, duke i rekomanduar Komisionit Përgjegjës sa më poshtë:

**1. Në nenin 2:**

- Të rishikohet përdorimi i termit “neglizhencë” në raport me termin “pakujdesi”, duke qenë se neglizhenca është një nga llojet e pakujdesisë;
- Të bëhet referimi tek zbatimi i protokolleve të mjekimit, me qëllim evidentimin e elementit të pa vetëdijes, në rastin e neglizhencës;
- Të hiqet paragrafi i fundit, i cili parashikon si rrethanë rënduese rastin kur vepra ka shkaktuar infektimin me HIV/AIDS, pasi reflekton realitetin e kohës kur është formuluar dispozita, i cili nuk përputhet me realitetin aktual. Tashmë HIV/AIDS është sëmundje e mjekueshme, madje e shërueshme;

**2. Në nenin 4:**

- Të riformulohet neni në aspekt të teknikës legjislative, duke e ndarë në paragrafë;
- Të mbetet edhe dënimi me gjobë, përveç atij me burgim.

### 3. Neni 5 të riformulohet si vijon:

#### “Neni 5

Neni 201 ndryshohet, si më poshtë vijon:

#### “Neni 201

*Ndotja e ajrit, ujërave dhe e tokës*

*Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues, të substancave të rrezikshme, ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, e bërë tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet.*

*Po kjo veprë, kur është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*

*Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.*

*Kur kjo veprë ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e rëndë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.*

*Po kjo veprë, kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë vdekjen e një ose disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.*

### 4. Në nenin 6 :

a. Titulli i nenit 201/a të bëhet : “ *Prishja e ekuilibrit natyror të një ekosistemi*”;

b. Neni 201/b të riformulohet:

#### “Neni 201/b

*Menaxhimi i mbetjeve*

*Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e vend-depozitimeve si dhe veprimet e ndërmarra nga tregtari ose ndërmjetësi, në shkallje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.*

*Po kjo vepër, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.*

*Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet”;*

c. Neni 201/c të riformulohet:

***Neni 201/c***  
***Transportimi i mbetjeve***

*Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo-të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet.*

ç. Neni 201/d të riformulohet:

***“Neni 201/d***  
***Aktivitetet e rrezikshme***

*Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose kanë mundësinë të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.*

*Kur vepra e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.*

*Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”*

d. Neni 201/e të riformulohet:

***“Neni 201/e***  
***Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme***

*Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.*

*Kur vepra e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.*

*Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzetë vjet.”*

**5. Neni 7 të riformulohet, duke e ndarë në dy nene, 202 dhe 202/a, me përmbajtje si vijon:**

“Neni 202

*Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër*

*Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën-produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet”.*

- Rekomandojmë të rishikohet përdorimi i termit “sasi të papërfillshme”, në mënyrë që të mos lerë vend për abuzime në zbatim.

“Neni 202/a

*Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër*

*Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën-produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”*



**6. Neni 8 të riformulohet:**

“Neni 8

*Pas nenit 202, shtohet neni 202/1 me përmbajtje si vijon:*

*Neni 202/1*

*Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore*

*Veprimet në shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore, dënohen me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.”*

**7. Në nenin 20, paragrafi i parë i nenit 288 të riformulohet:**

*“Cilido që importon, prodhon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime të rrezikshme, si dhe shton gjatë prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportit dhe/ose shitjes, kimikate, materiale dhe lëndë shtesë joushqimore të ushqimeve, në shkelje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm dhe që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, dënohet me burgim deri në tre vjet.”*

**8. Në nenin 21, të bëhen ndryshimet si vijon:**

a. Në nenin 288/c, paragrafi i parë të riformulohet:

*“Cilido që importon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime pas afatit të përdorimit, dhe që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”*

b. Në nenin 288/d, paragrafi i parë të riformulohet:

*“Cilido që importon, prodhon, ruan, ofron për shitje, shet apo vendos në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër ushqime, në të cilën janë shënuar të dhëna të rreme, të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë apo cilësisë së produktit, apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin e posaçëm dhe që rrezikojnë shëndetin, dënohet me burgim deri në tre vjet.”*

**9.** Në të gjithë përmbajtjen e projektligjit të rishikohen masat e dënimit, me synim rritjen e masës së gjobës dhe uljen e dënimit me burgim.

**10.** Të merret në konsideratë propozimi i ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin e neneve në grup veprat penale kundër mjedisit, konkretisht:

- Në nenin 205 të KP, që parashikon prerjen e paligjshme të pyjeve, pasi dispozita aktuale është krejtësisht e pazbatueshme në praktikë, për shkak të formulimit jo të qartë që ka dhe sanksionit që parashikon, i cili nuk i përgjigjet fenomenit masiv të prerjes së pyjeve, tendencës dhe rrezikshmërisë shoqërore që paraqet kjo vepër.
- Në nenin 206, që parashikon prerjen e drurëve dekorativë dhe frutor, pasi dispozita aktuale nuk siguron mbrojtjen efektive të kësaj pasurie.

**11.** Të plotësohet projektligji në aspektin formal, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores, duke qenë se i mungon baza ligjore.

**RELATOR**

**KRYETAR**

**Besnik BARAJ**

**Niko PELESHI**